


REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
Zyra e Kryeministrit - Urdhërmbajtës - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Dërgimi: 01
Nr. Dërgimi: 1059/18
Nr. Dërgimi: -PO-
Data: 10/04/2018
Prishtinë/a



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Zyra e Zëvendës Ministrit të Shëndetësisë, z.Granit ABDULLAHU

RAPORT PUNË PËR TRE (3) MUJORIN E PARË PËR VITIN 2018

Për Kryeministrin e Republikës së Kosovës:

z.Ramush HARADINAJ

➤ *Vizite në QKUK ne Klinikën e Kirurgjise Torokale*

Vizitë në QKUK në klinikën e Kirurgjirë TOROKALE, gajtë takimit me drejtorinë e Kirurgjirë TOROKALE u diskutuan shume tema atë ndryshme se si mundetë që ky repar të oragizohet në nivelin më të mire të mundshëm që shërbimi ndaj pacientit të jetë qdo herë me avancuar. Nga drejtori i klinikës u kerkua qe kjo klinikë të pajisetë me aparatur te BRONKOSOPIES dhe me VATS, si dhe hapjen e nj salle të kirurgjisë.

Ministria e Shëndetësisë është duke bërë përpjekje sëbashku me QKUK-në që këtë klinikë ta mbështesë me ato aparatura te kerkuara sidhe hapjen e një salle për kirurgji. MSH do të mundohetë që ti mbështesë të klinikate me kerkesat e tyre sipas mundesive që i ka, gjithëherë konform vijës buxhetore dhe mundësive që do ti ketë, do të jetë pranë tyre. MSH është e intersuar që mbështetja e kërkesave të fillojë nga kërkesatë që janë ma më prioritet për stafin sidhe për pacientin.

➤ *Takim pune me Bankën Boterore*

I nderuari kryeministër z.Ramush HARADINAJ, sigurimet shëndetësore ende janë në hapat fillister, por janë duke shkuar në rrugë te mbarë për ta gjetur modulim ma të mirë të mundshëm për të filluar me sigurimet shëndetësore. MSH falenderonë të gjithë akterëtë që janë duke e ndihmuar Ministrinë e Shëndetësisë për të vendsur hapet e parë për të filluar me sigurmiet shëndetësore, një falenderim i veqantë ju takon edhe juve i nderuari Kryeministër që në vazhdimësi jeni në mbështje të këti projekti madhorë ku edhe Ministra e ka më të lehetë punëne e saj pasi që ka përkrahjen e juaj z.Kryeministër.

Në këtë takim me bankën botërore u analaziu dhe u diskutua se si të fillojmë me procesin e sigurimeve shëndetësore që është jetike për shëndetsinë dhe popullatën tonë.

Ministria e Shëndetësisë dhe ministri z.Uran ISMAJLI, janë duke punaur në vazhdimësi që procesi i sigurimeve shëndetësorë të jenë gjithmonë në rrugë të mabarë dhe jo të stangojë si në të kaluarnën. Ne jemi në rrugë te mbarë dhe shpresojmë që për një periudhë dy vjeqare të fillojmë me sigurme shëndetësore.

➤ *Takim pune me zyrtar të UNDP-së*

Në këtë takim u diskutua për përvojatë e menaxhimitë dhe ngritjen e bashkëpunimitë me të lartë. Ky takim ishte frytëdhënës se si duhetë të menexhohën situatë të ndryshme dhe si duhetë të jetë një bashkpunim sa më lartë. Nga përvojatë e ndryshme që u cekun në këtë takim, ishinë produktive për MSH. Nëse kemi një menaxhim të mirë dhe një bashkpunimë të lartë aty ku vepronë, atëher nukë do të mungonë edhe rezultati, kështu që Ministria e Shëndetësisë është duke bërë përpjekje që menaxhami dhe bashkpunimi të jetë sa më i lartë qdo here, në qdo sektorë të shëndetësisë.

➤ *Diakonie Kosovë*

Diakonia Kosovë, është qendër psikosociale që vepronë në Mirtovicë. Kjo qendër mirrët me probleme psikosocile për traumatologji. Gjtë një takimi në këtë qendër u bisedua rrethë “traumës dhe atashimit”. Psikotraumatologjia është fenomenë shoqërorë, familjarë dhe individual traumatikë të përjetuar në jetë dhe i nënshtrohën shpesh këtyre fenomenëv:

a) nga detyrimi, b) nga shtangjija, c) nga boshllëku, d) nga mpirja, e) nga harresa, e) dhe nga persiritja.

Disa shembuj se si pësonë një shoqveri e tër nga Psikotraumatologjia (trauma dhe atshimi), psh. Nag lutratë dhe krizatë e ndryshme, si përshembullë lufta e parë botërore, ku gjatë kesa lufte pseoj nje shoqeri e tere.

Shembulle lufat e pare Botëror:

Mbi ; 2.000 000 ushtarë Gjermanë të vdekur

Mbi ; 1.400 000 ushtarë Francezë të vdekur

Mbi ; 1.700 000 ushtarë Rusë të vdekur

Mbi ; 1.000 000 ushtarë Britanikë të vdekur

Mbi ; 1.200 000 ushtarë Austro-Hungarezë te vdekur

Mbi ; 20.000 000 viktima të luftës.

Siq e dimë edhe në vedi ynë ka kaluar napër shumë luftra duke perfshirë edhe dy lyftratë Botëror. Sipas organizatës per mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriutë të Kosovës, gjatë luftës së funditë në Kosovë kishim:

13.000 të vdekur

65.000 të lënduar

3.800 persona të zhdukur

10.000 femra të dhunura

800.000 të debuar nga Kosova

160.000 të debuar nga shtepitë e tyre mbrenda Kosovës

230.000 shtëpi dhe ndërtesa të shkatrruara.

Inderuari Kryemenistër, një shoqëri e dalur nga lufta nukë mundetë që të mos ketë edhe trauma e atashime. Ne si soqëri dhe si shtetë duhetë te mundohemi në maksimum të ju dalimë në ndihmë kesaj kategorie te prekur nga Psikotraumatologjia. Nga kjo organizatë u kerkua qe Ministria e Shëndetësisë ti mbështesë dhe ti perkrah ne forma të dnryshme. Ministria e Shëndetësisë në bashkupunimë edh me Qeverinë e Kosovës do ta mbeshtes me forma dhe mundesi të ndryhme këtë kategori te shoqerisë sonë dhe do të jetë sa ma afër kesaj shoqerie. I sigurojm se MSH nuke do të ndalete as njëherë që të jetë sa ma afer të qdo kategorie të shoqerisë së vendit tonë.

➤ *Urgjencat në fushën e futbollitë dhe Anti-dopingu*

Konferencën e parë Mjekësore e organizuar nga Federata e futbollitë të Kosovës dhe UEFA. Me temen “Urgjencat në fushën e futbollit dhe Anti-dopingu”

Gjatë kësaj koference u diskutua si të ndalohetë dopingu te spotistët tanë e në veqanti te futbollit. Shqetësuse ishte mungesa e nej laboratorit per anti-doping.

Nga organizatorët e kësaj konferenca u kërkua që Ministria e Shëndetësisë ti përkrah me një laborator për anti-doping.

Në si ministri do të mudohemi që të sigurojmë një laborator dhe kjo kërkesë e tyre është në proces e sipër duke i shqyrtuar mundësitë tona për ti përkrahur me një laborator anti-doping.

Ligjërues nga UEFA kanë qenë: z. John MacLean (Skoci) dhe z. Richard Grisdale (Zvicër)

➤ *Parandalimi dhe rreziqetë nga HIV*

Kosova si vendë përballet më sfida të mëdha socio-ekonomike dhe politike: shkallë të lartë të varfërisë dhe papunësisë, rritjes së përdorimit të drogave, sjelljeve seksuale me rreziqë të lartë, komunitetë të MSM-ve të stigmatizuar, lëvizshmëri të shpeshtë të kosovarëve për dhe nga vendetë me prevalencë të lartë dhe të gjithë këta faktorë mund të nxisin një përhapje të shpejtë të epidemisë së HIV-it nëse ato nukë adresohenë në mënyrë të drejtë.

- MSH ka bërë përpje të vazhdueshme që problemin e HIV-it ta adresojë në mënyrë të drejtë, në parandalim dhe trajtim. Dhe e gjithë kjo falë mbështetjes nga organizatat ndërkombetare në pergjithësi dhe fonditë global ne veçanti.
- Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë të mbulojë shpenzimetë për terapi Anti Retrovirale (ARV)
- Prokurimi i terapisë (ARV) realizohetë përmes UNICEF-it
- MSH siguron materialin harxhues për realizimin e testeve që ndihmojnë njohjen e statusit imunologjik të pacientëve me HIV dhe AIDS si dhe sasinë

e virusit në qarkullim të gjakut që janë në terapi dhe ndihmon infektologët në monitorimin e gjendjes së tyre.

- Ministria e Shëndetësisë nga ky vitë ka filluar t'i mbuloj shpenzimetë për Terapinë Mbjajtëse me Metadon, ky shërbim ofrohet në 5 qendra të licencuara në Kosovë.
- Në Klinikën infektive janë trajtuar dhe janë duku u trajtuar persona të infektuar me HIV

Ministria ka aprovuar strategjinë dhe planinë e veprimit 2018-2022, MSH do të jetë e përkushtuar ne realizimin e kësaj strategjie.

Ministria e Shëndetësisë i falenderonë profesionistët shëndetësor (ikshp, klinika infektive etj), zyrtarët e MSH dhe partnerët tjerë vendor dhe nderkombetar UNICEF-in, OBSH, CDF/Fondin Global, UNFPA . Që kanë bërë të mundur që niveli i prevalencës së HIV-it të jetë në nivel të ulët.

➤ *Anomalitë e lindura të zemrës*

Perkushtimi pvr shëndetinë e mirë të nënave dhe femijëve paraqetë prioritetë mbi prioritetë për Ministrinë e Shëndetësisë të cilin në dokumentetë tona të politikave strategjike shëndetësor e kemi definuar si perkushtimë për fillim të shëndetshum te jetës .

Por ky vizion ballafaqohetë me realitetë teje sfiduesë. Kosova ka popullatën më të re edhe për kundër rënjës në vitet e funditë prap kemi shkallën më të lartë të natalitetit në Evropë dhe një kohësishtë për fatë të keqë Kosova ka shkallën më të lartë të vdekshmerisë së foshnjave e cila është shumë herë më e lartë se në vendetë e BE-së.

Ne synojm zhvilliminë e shërbimeve cilësore e shëndetësore me qasje më të lehtë për nënatë dhe femijëtë, gjithashtu me një qasje bashkëhore që do të

rezultojnë në përmisimin e statusitë shëndetësor të këtyre grupeve të ndjeshme të popullatës si dhe ngritjen e kualitetit të jetës së tyre .

Në këtë drejtimë perkushtimin tonë e tregon edhe investimin që po bëhet për shëndetin e fëmijëve ku me programin e huamarrjes nga Banka Botrore janë siguruar pajisje për shërbime për nënatë dhe fëmijët në të gjitha spitalët e pergjithshme dhe këshilli për Obsteter dhe Gjinokolog, klinikën e Neonatologjisë, klinikën e Pediatrisë. Poashtu nga Emiratet e bashkuara Arab-Fond i familjës mbretërore ka filluar te realizohetë ndërtimi i Spitalit të Kirurgjisë Pediatrike.

Nga, Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të investimeve kapitale qdo vitë shpenzohen- ndahën mjete për investime kapitale, psh: para 3 vitësh është ndertuar Emergjencia Pediatrike së bashku me AIHA, kurse këtv vitë është siguruar Autoambulanca për transportin e të posalindurve.

Me përkrahjen e agjencionëve OBSH është organizuar edhe trajnimi për diagnostikimin e anomalive kongjenitale të zemrës dhe njohuritë nga ky trajnim janë bartur tek profesionistetë shëndetësor.

Për këtë qëllim, do të shërbenë edhe simpoziumi shkencor mbajtur me temën "anomalitë e lindur te zemerës". Ku permes shkembimitë të provojave njohurive dhe prezentimetë e reja shkencore do të kontriboj në diagnostifikimin e hershum të anomalive dhe trajtimin e tyre me kohë.

Ministria e Shëndetësisë shprehë gadishmërinë pvr ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe të ofroj bashkpunim të plotë me profesionistë shëndetësorë me qëllimë të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nënatë dhe foshnjët. Ministria e Shëndetësisë zotohetë se do të vazhdoj të investoj në shëndetin e fëmijeve tonë sepse është investimë në ardhmërinë tonë.

➤ *Oda e Mjekëve te Kosoves*

Me autorizimin e ministritë z.Uran ISMAJLI dhe gjithë herë në kordinim të plotë me Ministrinë. Nga dita e shpalljeve e zgjedhjeve në Odën e Mjekëve te Kosovës i kam percjellur në vazhdimësi zhvillimetë zgjedhore në Odën e Mjekëve të Kosovës.

Oda e Mjekëve e Kosovës në kuvendin zgjedhore, në mënyr demokratike zgjodhi strukturat e saj. Në atë Kuvende kryetar u zgjodhë dr.Pleurat SEJDIU.

.....

Kështu që, gjatë takimit që pata me perfaqësuesitë e Odës së Mjekëve u diskutua rrethë bartjes së kompetencave te Oda e Mjekëve me dispozitatë ligjore të përcaktuara në ligjin për Shëndetësi dhe në ligjin për Odën e profesionistëve shëndetësor dhe funksionalizimi saj në mnyrën më të mirë të mundshëm. I nderuar Kryeministër, në të kaluarin, Oda e Mjekëve nukë është funksionalizuar siqë duhetë dhe nukë janë bartur kompetencatë sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në ligjin për Shëndetësi dhe në ligjin për Odën e profesionistëve shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë, zotohetë se do të realizojë të gjitha obligimet ligjore, me qëllim të bartjes së kompetencave në Odën e mjekëve, duke realizuar një objektiv të rëndësishëm drejt implementimit të reformës në sektorin e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë do të ketë rolinë mbikqyrës dhe politkberës dhe do të sillete konform ligjitë për Odën e Mjekëve të Kosovës.

*➤ Takim pune në MPJ me zv.Ministrenë e Punëve të jashtëm
znj.Rejhane VUNIQI*

Me ftesë të zv.Ministrës znj.Vuniqi, morra pjesë në takim punë me zv.Ministrinë e Shëndetësisë nga shteti Turk. Tema diskutimi në këtë takimi ishte shëimi i fëmive jashtë venditë me mundësi më të mira. Gjëtë këti takimi me zv.Ministrinë e Shëndetësisë nga shteti Turk dhe me zv.Ministrenë ne fjalë ngas MPJ, u dakorduam që të vazhdojmë thelliminë e bashkupunimitë në mesë dy ministrive dhe të gjejmë mnyra më të leheta dhe më të shpejta për dergiminë e fvmive për shërimë jashtë venditë e në veqanti në shtetin Turk, e jo të ketë pengesa dhe vonesa të panevojshme për disa dokumentapor te gjendtetë mundesia që ato dokumenta që të munden te kryenë nga te dy anetë ne mnyren më të shpejtë dhe më të lehetë.

Ministria e Jashtëm e Kosovës si organizatore e këti takimi, u shprehë e gatshme që të na mbeshtesë në qdo kohë për thellimin e bashkunimit bilateral në mesë dy Ministrive të Shëndetësisv.

Ministria e Shëndetësisë dhe ministri z.ISAMJLI janë të perkushuar që të thellohen edhe ma shumë mardhënjete bilaterale në mesë dy ministrive asaj Turke dhe të Kosovës.

➤ *Tyrezë Shikencore nga MMEPI per Ajrin*

Problemetë kryesore mjedisore në Kosovë perfshijne ndotjen e ajrit, pamjaftueshmeria me furnizim me ujinë higjenikë dhe degradimi i Tokës, pastaj rreziqetë nga fatkeqësitë dhe ndryshueshmeria e klimes, paraqesinë kërcënim seriozë ndaj shëndetit të qytetarëve të Kosovës.

Pavarësishtë se sektori i shëndetësisë ballafaqohetë me shumv probleme të akumuluarua ndër vite, gjithashtu ballafaqohetë me pasojatë e ndotjës së mjedisitë, megjithatë Ministria e Shëndetësisë është pjesë aktive në mbrojtjen e mjedisitë. Komiteti për shëndetë mjedisor është i përbër nga përfaqësues të lartë të strukturave politikëbërësë, istitucioneve profesionale dhe organizatave nderkombetare që në mënyre të drejtperdrejtë apo jo është drejtperdrejtë janë të involvuar në aktivitetë që nderlidhen në shëndetë mjedisor. Ministria e Shëndetësisë është e gatshme që të ndihmojë në hartiminë e Politikave mjedisore dhe njekohehishte të ballafaqohetë me pasojaët e mundshme mjedisore që ndikojnë në shendetinë e qytetarit tonë.

➤ *Parandalimi i Kancerit të gjiritë*

Ministria e Shëndetësisë është e perkushtuar në vedisimin për indefikimin e hershëm të kanceritë të gjiritë dhe paranadalimin e kanceritë të gjiritë. Ministria e Shëndetësisë në bashkupnim me organizatatet nderkomtare dhe vendore do ti marrë të gjitha masat e nevojshëm për vedisimin e popullates për indetifikimin e hershëm të kancerite të gjiritë e sidomos popullatës të ciletë janë në vende mv të thella të venditë tonë.

➤ *17. Vizite ne Komunen e në Lypjanit*

Gjatë viztës në Komunen e Lypjanit, prezentë ishinë Nënkrjetari i Komunës dhe Drejtoreshe për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Gjatv keti takimi u diskutuan shumë tema të ndryshme se si mundetë shëndetësia në Lypjan të ketë njv organizim më të mirv dhe qka mundimë të bëjmë në atë drejtim për ta oragnizuar edhe ma mirë shendetsinë në Lypjan. Gjithastu teme diskutime ishte matarnitetit pasi qe kishte shumë pak lindje ne spitalin e Lypjanit ne vitin 2017, dhe ky faktë ishte shqetësusë.

Nga ana e tyre u kerkua qe Ministria e Shendetsise ta ndimoje me INSULIN, me një AUTO-AMBULANCE sidhe me hapjen e vendeve të lira të punësë për Mjekët.

Ministria e Shëndetësië me seriozitetë i ka marrë kerkesatë dhe shqetesimetë e tyre për ta ndihmuar INSULIN, me një AUTO-AMBULANCË, kurse sa i përketë hapjësë së vendeve te lira për Mjek, MSH ne pergjithesi është e perksultuar që të hape vende të lira pune për Mjekë. MSH ne perputhje me vijen buxhetore dhe konform normave ligjore do të bënë edhe hapjen e vendeve të lira për Mjek.

➤ *Tryezë - Mbyllja e materniteteve në Kosovë, shkaktarët si dhe mundësia e tejkalimit të kësaj situatë dhe rifunkcionalizimi tyre*

Përkushtimi për shëndetin e mirë të nënave dhe të fëmijëve është një ndër prioritetët e Ministrisë së Shëndetësisë të cilin në dokumentet tona dhe politikatë strategjike shëndetësore e kemi definuar si përkushtim për fillim të shëndetshëm të jetës. Sepse jemi të sigurt që kur kemi nëna dhe fëmijë të shëndoshë, si shoqëri mundë të llogarisim në të ardhme të sigurtë.

Roli i mamive është thelbësor për të arritur në rend të parë e qëllimin e Permirsimit të Shëndetit, Mireqenjesë dhe Sigurisë së nanave, foshnjave dhe gjithë popullatës.

Shërbimet e mamive janë çelësi i planifikimit familjar, shtatzënisë dhe lindjes së sigurt, si dhe të posalindurve të shëndetshëm. MSH mbështet përpjekjet e mamive për të siguruar që çdo femër dhe çdo foshnjë e posalindur të marrin kujdesin më të mirë shëndetësor të mundshëm.

MSH nuk ka mbyllur maternitete. Maternitetët të cilat janë mbyllur, janë mbyllur në bazë të vlerësimit të vetë komunës.

- Maternitetet në kauder të QKMF janë në kompetencë të Drejtorateve Komunale për Shëndetsi dhe Mireqñjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë e përkrah Zhvillimin e KPSH-se.
- Maternitetet funksionojnë me shërbimet të cilat i ofrojnë aktualisht.
- Për mbylljen e materniteteve, vendimi i takon KPSH, aktualisht MSH nuk ka informacione se maternitete mendohen të mbyllën nga Drejtoratet Komunale për Shëndetsi
- Organizimi dhe funksioni i materniteteve të gjitha mbahet nga Drejtoratet Komunale për Shëndetsi – Mireqñje dhe Sociale dhe jo nga Ministria e Shëndetësisë pasi që maternitetet janë kompetencë e DKSHMS dhe Ministria do të përkrahë fuqishëm për funksionalizim dhe organizimin më të mirë të materniteteve
- Është hartuar një draft dokument për përshkrimin e detyrave të punës, nivelizimin, koeficientin, përgjegjësit, kompetencat profesionale, detyrat dhe gradimi në sistemin e pagave për Infermier/e të Diplomuar, Mami të Diplomuar, Fizioterapeut/e të Diplomuar, Infermier/Mami – Shkollë e Mesme, Teknik Fizioterapie – Shkollë e Mesme, Ndihmës Infermier/Mami - Shkollë e Mesme etj. **Draft dokumenti U/A për kompetencë Udhëzimin administrativ (shëndetësi) me nr.XX/2013 ende është draft dokument dhe pritet të hyjë në planin legjislativ për vitin 2018**
- Në komisionin për hartimin e draft dokumentit, nga mamitë i ka përfaqësuar koordinatorja e degës së Infermierisë /Mamive në kuadër të UP-FM. (vrejtje duhet të gjendet emri i përfaqësueses)

Ministria e Shëndetësisë ka bërë vlerësimin e performancës së materniteteve në Kujdes Parësor Shëndetësor dhe është duke analizuar raportin e vlerësimit për të nxjerrë rekomandime për hapat e mëtejshëm.

➤ Dreکہ pune me UNFPA

Në këtë takim pune me UNFP ishim sëbashku me sekretarin e Ministrisë. Gjatë keti takimi u diskutua thellimi i bashkupunimit me UNFPA-në dhe permisimin e kushteve në Klinikën e Gjinokologjise (në repartine e Maternitetit dhe Neatologjise).

Ministria e Shëndetësisë u shprehe gatshem dhe është gatshme që qdo herë ti thelloj bashkupunimin me UNFPA-në dhe gjithashtu për permisimin e kushteve në Klinikën Gjinokologjike (në repartine e Maternitetit dhe Neatologjise).

➤ *Finnish Baby Box, nga ambasadorja e Finlandës për nderë të 10vjetorit të Pavarësisë së Kosovës*

Ambasadorja e Finlandës për nderë të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, me 17 Shkurte 2018 vizitoi Klinikën e Gjinekologjisë (repartine e Neonatologjisë) ne Spitaline e Prishtinës.

Ambasadorja Finlandese gjatë kësaj vizite bëri një dhuratë simbolike fëmijes së parë të lindur me date 17.02.2018 duke dhuruar Finnish Baby Box.

Ambasadorja Finlandese, falnderoj Stafin Klinikës dhe Kosovarët ne pergjithesi për Miqësinë dhe miqepitjen e tyre sidhe shprehi gatishmërinë e Ambasadës Finlandese për bashkupunim në të ardhmën dhe për ta ndihmuar QKUK-në. Gjithashtu uroj ditën e Pamavaresise.

Me këtë rast, në emer të Ministriesë së Shëndetësisë dhe Qeveriesë së Kosovës e përgëzoj Ambasadorën e Finlandës në Kosovë për detyrën e re, gjithhstu e falënderoj Ambasadoren që ka zgjedhur pikërisht klinikën e Gjinekologjisë që me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ta vizitoj dhe ta përkrahë një prej klinikave më të rëndësishme te vendite tone.

Gjatë këti takimi me Ambasadoren Finlandese zhvilluam një bisedë teje miqësore dhe u dakorduam që të thellohet bashkepunimi mesë MSH dhe Ambasadese Finlandese.

➤ *Tryezë - Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirite*

I nderuari kryeministër z.Ramush HARDINAJ, Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar fuqishëme për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjiri, për ta përmirësuar shëndetin e nënave dhe fëmijëve tanë.

Përkushtimi për shëndetin e mirë të nënave dhe të fëmijëve është një ndër prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë të cilin në dokumentet tona dhe politikat strategjike shëndetësore e kemi definuar si përkushtim për fillim të shëndetshëm të jetës. Sepse jemi të sigurt që kur kemi nëna dhe fëmijë të shëndoshë, si shoqëri mund të llogarisim në të ardhme të sigurtë.

Arritjes së qëllimeve tona , padyshim i kontribon edhe iniciativa fillimisht për hartimin e Ligjit për nxitjen e të ushqyerit me qumësht gjiri (viti 2006) duke konsideruar se të ushqyerit me qumësht gjiri ndikon në uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së foshnjave. Gjatë zbatimit të këtij ligji jemi ballafaquar me shumë sfida dhe në vitin 2015 është paraqitur nevoja për revidimin e tij.

Kështu nga viti 2015 ne kemi Ligjin në fuqi për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri. Prandaj sot jemi këtu që së bashku të diskutojme për sfidat që po na pëcëjllin për zbatimin e këtij ligji në praktikë.

Ne si ministri, jemi thellë te bindur se suksesi i zbatimit të Ligjit do të jetë indikator shumë i mirë për përmirësimin e shëndetit dhe mirqenies, rritjes dhe zhvillimit normal të fëmijëve tanë . Prandaj ftojë të gjithë profesionistët shëndetësor, dhe partneret relevant që të bashkërenditen dhe të kontribuojnë në zbatimin e ligjit në fjalë si dhe arritjen e rezultateve që synojmë.

Zbatimi i këtij ligji do ta zvoglone sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë nënave dhe foshnjëve.

Në këte takim tv pamsihvm ishin edhe nga UNICEF-i dhe nga UNFPA-ja. Nga zyra e UNICEF-i në Prishtinë ishte z.James Mugaju, kurse nga zyra e UNICEF-i ishte znj.V. Nimani-Mujko-Shefe e zyrës së UNFPA-së.

Nga perfaqësuesi i UNICEF-it dhe nga shesja e zyrës së UNFPA-së, kishte fjale te mire për punën që është duke u bërë për permsimin e te ushqyerit me qumësht të gjirit. Gjithahstu kishte edhe vrejttje me vende kur kerkuan qe zabtimi i ligjite te zbatohet ne perpikeri per ti mbrojtur nënatë dhe foshnjët.

➤ *Takim pune me Ambasadorën e Finlandës*

I nderuari kryeministër z.Ramush Haradinaj, siqë është cekur më lartë në raportë, se gjatë vizistës që beri Ambasadorja Finlandese për nder te 10 vjeorit të Pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2018. Në atë takim ne u dakurduam për ti thelluar bashkëpunimin dhe me ftesë te Ambasadorës une vizitova Ambasadën Finlandese me dt.07.03.2018 dhe gjatë takimit me Ambasadorënë arritëm një dakordim që Ambasada Filandese ta ndihmoj QKUK-në me ndihma në pajisje mjekësore. Dhe kjo ndihmë e cila do të jetë me një vlerë të konsiderueshme do të realizohetë gjatë muajit Maj të këti viti. Ne si ministri dhe nga ana QKUK-së i kemi perfunduar të gjithë procedurat e keëkuara nga ana e Ambasadës, tani jan në procese e siper procedurat nga ana e Ambasadës, të cilëtë janë shprehur te bindur se kjo ndihm për QKUK-ne do te realizohet ne muajin MAJ te keeti viti.

Ne si Ministri jemi shumë falenderuesë ndaj Ambasadoressë Finlandesë për këtë ndihm që do të bëhetë për QKUK-në

➤ *Pjesëmarrja në promovimin e doracakut për monitorim dhe vlerësim të strategjisë sektoriale*

Ceremonia per lansimin e Doracakut për Monitorim dhe Vlerësim të Strategjisë Sektorial të Shëndetësisë 2017 – 2021, organizuar nga Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor.

Ministria e Shendetsise gjithmone eshte munduar dhe do te mundohet qe qdo inicitve qe behetë per te mirene e Shendetesise se Kosoves, eshte gatshme qe ta perkrah dhe organizon: simpoziume shkecore, tryeza, seminare, trjnime, mbeshtetje per doracaku te ndryshem siqe eshet ky doracak i larte cekur, etj.

➤ *Kuvendi vjetor i shoqatës së mamive të Kosovës, Qendra e telemjekësisë*

Kuvendi vjetor i shoqatës së mamive të Kosovës të mbajtur më 15.03.2018, në menyrë demokratike zgjodhi strukturat e saj.

I nderuari kryemister z. Haradinaj, edhe një herë i siguroi shoqatën e mamive së Ministria e Shëndetësisë është e përkushtuar për shëndetin e mirë të nënave dhe të fëmijëve dhe është një ndër prioritetet e Ministrit z. Uran Ismajli dhe Qeverisë së Kosovës.

Roli i mamive është thelbësor për të arritur në rend të parë e qëllimin e Permisimit të Shëndetit, Mireqenjes dhe Sigurisë së nënave, foshnjëve dhe gjithë popullatës.

Ministria e Shëndetësisë i sugron shoqatën e mamive së MSH nuk i ka mbyllur maternitetet, maternitetet të cilat janë mbyllur janë mbyllur në bazë të vlerësimit të vetë komunës.

I nderuari Kryemister z. Haradinaj, Ministria e Shëndetësisë ka bërë vlerësimin e performancës së materniteteve në Kujdes Parësor Shëndetësor dhe është duke analizuar raportin e vlerësimit për të nxjerrë rekomandime për hapat e mëtuftjeshëm

➤ *Dita Botërore e Tuberkulozit - Ferizaj*

Kan kaluar më shumë se një shekull pas identifikimit të bakterit TB nga Robert Koch, edhe në vitin 2018 tuberkulozi mbetet një vrasës i madh në mbarë botën.

Çdo vit, më shumë se dhjetë milionë njerëz marrin këtë sëmundje, dhe për më keq, rreth 1.8 milionë njerëz në mbarë botën vdesin prej TB.

E vërteta e trishtuar është se edhe pse Tuberkulozi tani është sëmundje e parandalueshme dhe e shërueshme, ajo ende vret më shumë njerëz se sa EBOLA, se sa HIV-i, se sa çdo sëmundje tjetër infektive.

Është pak shqetësues fakti se Kosova prin në rajon me numrin e pacientëve me këtë sëmundje. Gjatë vitit 2017 ishin rreth 720 veta të prekur nga Tuberkulozi. Mirëpo kur shikojm të dhënat për Tuberkulozin, atëherë ndjehemi optimist, sepse ka një ulje të numrit të pacientëve nga kjo sëmundje nga viti në vit.

Numri i pacienteve është përgjysmuar prej vitit 2000 e deri me tani. Suksesi i trajtimit të pacientëve është i lartë rreth 86%. Kjo tregon se po punohet në këtë program.

Kjo tregon se kemi për profesionistë shëndetësor të përkushtuar në të gjitha institucionet ku ofrohen shërbimet për këta pacientë.

Gjithashtu, kjo tregon për rritje të vetëdijesimit të pacientëve dhe komunitetit për shëndetin e tyre.

Është një vazhdimësi e mirë që prej disa vitesh që Ministria e Shëndetësisë ka pasur me partner strategjikë vendorë dhe të huaj, sidomos me Fondin Global dhe OBSH-në, të cilat me asistencë financiare dhe ekspertizë profesionale kanë dhënë dhe po japin një kontribut shumë të vlefshëm në parandalimin e Tuberkulozit.

I nderuri Kryeminister, MSH i mbështet fuqisihem polmuloget në luftën kundër Tuberkulozit, në betejën për të fituar luftën kundër kësaj sëmundje. Polmuloget nuk jone vetëm dhe do të ken gjithmonë përkrahjen e vazhdueshme të institucioneve qeveritare dhe në veçanti të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë i siguron pacientët me TB, dhe familjarët e tyre se për asnjë minutë nuk do të mungojnë barnat antituberkulare, nuk do të mungon as diagnostikimi i pacienteve dhe nuk do të mungon as shërbimi cilësor që do t'ju ofrohet atyre.

Shtesë:

- Barnat që përdoren për trajtimin e Tuberkulozit janë të parat që Ministria ka zotuar dhe ka realizuar blerjen e tyre. Ato tashmë ndodhen në Depon Qendrore të ministrisë dhe brenda pak ditësh do të shpërndahen nëpër të gjithë institucionet publike shëndetësore.
- Mbështetja dhe definimi si prioritet i TB-së në strategjinë sektoriale shëndetësore, përfshirja e indikatorëve të Tuberkulozit në Doracakun e Monitorimit dhe Vlerësimit të SSSH-së 2017-2021;
- Përkushtimi financiar për blerjen e të gjithë reagjensave dhe produkteve mjekësore laboratorike;

- Diagnostikimi me metodat më të reja botërore për këtë sëmundje bëhet edhe në Kosovë në institucionet publike;
- Planifikimi për hartimin e udhërrëfyesve të rinj për tuberkulozin për gjatë vitit 2018.

Përkundër rezultateve optimiste dhe luftes kunder Turbukulozit, na mbetet ende punë për të bërë.

➤ *Takim në Viti- Vizitat shëndetësore në shtëpi*

Ministria e Shëndetësisë ka filluar vizitate në shtëpi për kujdesin për nëna dhe fëmijë që janë në përputhje me prioritetet strategjike të Ministrië së Shëndetësisë, për të ofruar qasje për të gjithë dhe për të mbrojtur dhe përmirësuar gjendjen shëndetësore të nënës dhe fëmijës.

I nderuari kryeminister, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me QKMF deri ne funde te mujit Mars ka arritur të prezantoj vizitat në shtëpi në keto komuna (Prizren, Dragash, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Lipjan, Obiliqi, Fushë-Kosovë, Shtime, Viti dhe Kamenicë).

Ministria e Shëndetësisë, e përkrahur nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë, ka prezantuar programin e vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë deri ne tre vjet, për të mundësuar vazhdimin e kujdesit, performancë më të mirë, qasjes universale dhe të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore.

Gjatë këtij procesi është punuar shumë duke filluar me konferencës që është organizuar në vitin 2013 në bashkëpunim me MASHT-in dhe MPMS duke arritur konsensusin për zbatimin e vizitave në shtëpi. MSH ka bërë miratimin e grupit punues me përbërje të institucioneve të ndryshme dhe pakos për të ofruar shërbime sa më të mira dhe gjithëpërfshirëse.

Kam pasur privilegjin për të marrë pjesë edhe në konferencën me 30 nëntor në të cilën janë prezantuar rezultatet e arritura përmes vizitave në shtëpi dhe ndërtimin e besimit në mes të familjeve dhe sistemit shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë e ka përkrahur procesin e shqyrtimit për analizuar progresin dhe përmes të dhënave për të ndihmuar planifikimin dhe planet për zbatim në komunat e tjera.

Ministria e Shëndetësisë, e cilëson si prioritet KPSH dhe në kuadër të reformës shëndetësore, “Zbatimi i Konceptit të Mjekësisë Familjare” është një nga qëllimet specifike në Strategjinë Sektoriale për Shëndetësi 2017 – 2021.

Qëllimi i MSH është për të ju ofruar shërbimet në vende që janë më të largëta dhe kjo është një nga këto intervenime.

Përvojat e ndryshme dëshmojnë se qasja ndaj kujdesit primar shëndetësor është mënyra më efikase, më e drejtë dhe më kosto-efektive për të organizuar një sistem të mirë shëndetësor.

Me përkrahjen e UNICEF-te është duke bërë përgatitjen e profesionistëve shëndetësor për të ofruar shërbime sa më cilësore. Janë mbajtuar takime të ndryshme dhe janë trajnuar rreth 300 profesionistë shëndetësor si dhe punëtor të tjerë të qendrave të punës sociale dhe arsimit.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017 janë ofruar 12,209 vizita për shtatzanënë dhe fëmijë deri në tre vjet.

I nderuari Kryeminister, ky program për vizite në shtëpi do të vazhdohet edhe më tutje deri në arritjen e qëllimit për një shëndetësi më të mirë për nënat dhe fëmijët.

Andaj, ju ftoj të gjithëve që të angazhohemi edhe më shumë, që së bashku ta realizojmë qëllimin tonë, përmirësojmë dhe ofrojmë shërbimet sa më cilësore, gjithëpërfshirëse, ta kemi mjekësinë familjare të sukseshme!

Për të arritur deri në suksesin e këtij programi, nuk kishte qenë e mundur pa bashkëpunëtor, andaj ne i falenderojmë të gjithë menaxherët e QKMF, profesionistët shëndetësor që janë duke zbatuar vizitat në shtëpi, qendrat e punës sociale, zyrtarët e sektorit të arsimit dhe zyrën e UNICEF-it për përkrahjen e madhe që është duke dhënë për zbatimin e këtij programi shumë të sukseshëm.

➤ *Ditën ndërkombëtare të Shëndetit Oral, Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi „KISCOMS“*

Në Ditën ndërkombëtare të Shëndetit Oral, Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi „KISCOMS“, në bashkëpunim me Komitetin ndërministror të programit ”Shkollat Promovuese të Shëndetit” oraganizoj Ecjen e katërt me radhë “Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur” që ka për qëllim informimin e fëmijëve-nxënësve mbi rëndësinë e shëndetit oral (shëndetit të dhëmbëve dhe të gojës).

Ne kete oragnizim pjesëmarrëse në ecje ishine mbi 2000 fëmijë-nxënës, prindër, familjar, edukatore, mësime dhënë të institucioneve parashkollore dhe fillore.

Ky ishte viti i gjashtë shkollor i realizimit të projektit “Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur” projekt që monitorohet dhe bazohet në rekomandimet e Komitetit ndërministror të programit ”Shkollat Promovuese të Shëndetit” nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Ministria e Shëndetësisë edhe ne te kaluarne edhe tani fuqishem i perkrah qdo inaciative qe ka te beje shendetine e te gjithëve e ne veqti te femive tane te cilete jane ardhmeria jone.

➤ *Përkushtimi përshëndetin e mire të nënave dhe të fëmijëve*

Përkushtimi për shëndetin e mire ndaj nënave dhe fëmijëve është një ndër prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë të cilin në dokumentet tona dhe politikat strategjike shëndetësore e kemi definuar si përkushtim për fillim të shëndetshëm të jetës. Sepse jemi të sigurt që kur kemi nëna dhe fëmijë të shëndoshë, si shoqëri mund të llogarisim në të ardhme të sigurtë.

Per te pasur nje shendet te mire te nenave dhe foshnjeve duhet te kete nje sherbimet te mire nga mamite dhe e mamite janë duke e bere nje sherbim shume te mire, siqe dihet mamit jane çelësi kryesor i planifikimit familjar, shtatzënisë dhe lindjes së sigurt, si dhe të posalindurve të shëndetshëm.

MSH i mbështet fuqishem përpjekjet e mamive për të siguruar që çdo femër dhe çdo foshnje e porsalindur të marrin kujdesin më të mirë shëndetësor të mundshëm.

Për kujdesin ndaj nënës dhe fëmijës, Ministria e Shëndetësisë është duke zbatuar edhe një program tjetër duke bërë vizita në shtëpi.

Edhe ky program po kontribuon në ndërtimin e besimit në mes të institucioneve shëndetësore dhe familjeve.

Ndryshimi pozitiv që po arrihet është sidomos në përmirësimin e praktikave të ushqyerjes me qumësht të gjirit dhe parandalimin dhe trajtimin e depresionit pas lindjes.

Me këtë qasje, Ministria e Shëndetësisë ka si qëllim të bashkojë të gjitha planet strategjike dhe të zhvillojë strategjinë gjithëpërfshirëse, të harmonizuar për të drejtuar ndërhyrjet e mëtejshme në ngritjen e sistemit të kujdesit shëndetësor.

➤ TAKIM ME DRJETORINË E DRJTORISË SË SHËNDETËSISË NË FERIZAJ

Gjatë këtij takimi u diskutuan teme të ndryshme dhe problemet që e percjellin shëndetsinë në Ferizaj, gjithashtu kishte kërkesa të ndryshme nga ana e drejtoritë z.Besnik BERISHA. Ne si Ministri jemi të gatshëm të ju ofrojmë ndihmë për ti zgjedhur problemet e ndryshme. Nga ana drejtorite u kerkua një Auto-Ambulance dhe Aparatur Shtesë DIANGOSTIKE.

Ministria e Shëndetësisë është duke bërë përpjekje që të realizohet kërkesa e bërë nga drejtori z.BERISHA.

➤ TAKIM ME DRJETORINE E DRJTORISE SE SHENDETSISE NE KAMENICE

Gjatë këtij takimi u diskutuane teme të ndryshme dhe problemet që e percjellin shëndetësinë në Kamenicë, gjithashtu kishte kërkesa të ndryshme nga ana e drejtoritë në veqanti ishte kërkesa për rritjen e mjekëve shëndetësor.

Ne si Ministri do të bëjmë përpjekje që ta rrisim numrin e mjekëve në Komunën e Kamenicës por edhe në Komunatë e tjera, konformë normave ligjore për rritjen e numrit të mjekëve shëndetësorë dhe vijes buxhetore.

➤ TAKIME DITORE NE ZYRE


I nderuari Kryeminister, z. Ramush HARADINAJ, në zyrë kam shumë takime ditore të ndryshme me palë të ndryshme për kërkesa të llojllojshme, duke u nisur nga ajo me më pak rëndësi e deri te ajo që me të vertetë janë shumë me rëndësi.

Dua të veqoj vetëm tri (3) kërkesa që janë me të veqara dhe të vazhdueshme:

- a) Sherimi jashtë vendit dhe mundësia për të verpuar sa më shpejtë
 - b) Ndihma me mekatamente (barna) të ndryshme që janë shumë të kushtueshme për pacientetë
 - c) Mundësia e punësime të Specializantëve
-

Një falenderim të veçantë dhe shumë meritore për Ministrinë
z.Uran ISMAJLI, i cili është teje bashkëpunues dhe te i cili
kamë gjetur çdo herë mbështetje në vazhdimësi.

z.Granit ABDULLHU



zv.Ministër i Shëndetësisë

Dt. 10 Prill 2108

10000 Prishtinë

Rep. e Kosovës